



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC**

---

Numri i lëndës: 2022:003340

Datë: 18.01.2023

Numri i dokumentit: 03871341

**PPP.nr.65/2019**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC –Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**, gjyqtari **Besmir Juniku**, në lëndën përmbare sipas propozimit për përmbare të kreditores K. E. e K. (KEK) SH.A.-Prishtinë, me adresë rruga "Sheshi Nëna Terezë"-Prishtinë, kundër debitorit Sh. D. nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për shkak të borxhit në vlerë prej 4,716.37€uro, i lejuar nga përmbareuesi privat Enis Hoxha në Prizren sipas Urdhërit përmbareimor P.nr.871/2018 të datës 19.12.2018, me datë **18.01.2023** merr këtë:

**A K T V E N D I M**

**I.Propozimi për përmbare** i kreditores K. E. e K. (KEK) SH.A.-Prishtinë, kundër debitorit Sh. D. nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, në lidhje me këtë çështje juridike përmbareimore **KONSIDEROHET I TËRHEQUR**, ashtu që përfundon procedura në këtë çështje përmbareimore.

**II.HIQET NGA FUQIA** Urdhëri i përmbareuesit privat Enis Hoxha në Prizren P.nr.871/2018 të datës 19.12.2018 dhe prishen të gjitha veprimet përmbareimore të ndërmarra nga i njëjti.

**III.Secila nga palët bartë shpenzimet e veta procedurale.**

**A r s y e t i m**

Sipas propozimit të kreditores K. E. e K. (KEK) Sh.A, me seli në Prishtinë, përmbareuesi privat Enis Hoxha në Prizren, ka lejuar përmbareimin në bazë të Urdhërit përmbareimor P.nr.871/2018 të datës 19.12.2018, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste, kundër debitorit Sh. D. nga fshati Krushë e Madhe, Komuna e Rahovecit, për shkak të

borxhit në emër të konsumimit të energjisë elektrike për periudhën prej datës 13.12.2015 e deri me datë 20.03.2013, në shumën e përgjithshme prej 4,716.37€uro.

Kundër urdhërit me të cilin është caktuar përmbarimi, debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, ndërsa kreditorja përgjigjje në prapësim.

Gjykata para se të vendos lidhur me prapësimin paraprakisht ka analizuar propozimin për përmbarim dhe përgjigjen në prapësim dhe ka ardh në përfundim se i njëjti nuk është i plotë, i mungojnë provat: Kontrata për dakordimin-pagesën e borxhit si dhe Deklarata për dakordimin e borxhit, që të dyja të datës 13.05.2016. Meqenëse kreditorja i ka përmendur këto prova dhe nuk i ka bashkangjitur, gjykata me Konkluzionin PPP.nr.65/2019 të datës 10.10.2022 i është drejtuar kreditores që brenda afatit prej 3 ditësh ta përmirësoj propozimin për përmbarim, në kuptim të dorëzimit të provave të potencuara. Kreditorja konkluzionin e ka pranuar me datë 18.10.2022 ndërsa deri më tani nuk ka vepruar sipas dispozitivit të tij.

Sipas nenit 17 të LPP-së në procedurën përmbarimore, përshtatshmërisht zbatohen edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e që në këtë rast për shkak se kreditorja nuk ka vepruar sipas dispozitivit të Konkluzionit PPP.nr.65/2019 të datës 10.10.2022 për dorëzimin e provave të cilat vetë i ka përmendur, gjykata ka vendosur që propozimi të konsiderohet i tërhequr dhe urdhëri përmbarimor të hiqet nga fuqia konform nenit 99.3, 101.1 dhe 102.3 të LPK-së.

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, konform nenit 17 të LPP-së në lidhshmëri me nenin 450 të LPK-së.

Nga arsyet e theksuara, konform nenit 17, të LPP-së lidhur me nenin 99.3, 101.1 dhe 102.3 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
**PPP.nr.65/2019, datë 18.01.2023.**

**Gj y q t a r i**  
**Besmir Juniku**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nëpërmjet kësaj gjykate.